



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1880, datë 19.04.2012**

**Për**

**“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit””.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”.**

## BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Rregullore nr. 23, datë 29.6.2012 “Për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit”, miratuar me Vendim nr. 1650, datë 29.6.2011, i ndryshuar;
- Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Albtelecom sh.a., me nr. 1406Prot., datë 20.3.2012 (nr. 531Prot. i AKEP, datë 21.3.2012) për “*Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit” dhe pranimin e ankimit.*
- Vendimi nr. 1778, datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”;
- Rregullore nr. 23, datë 29.6.2012 “Për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit”, miratuar me Vendim nr. 1650, datë 29.6.2011, i ndryshuar;
- Projektvendimin shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);  
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

- I. Albtelecom sh.a., në ankimin administrativ nr. nr. 1406Prot., datë 20.3.2012, për “*Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit” dhe pranimin e ankimit, parashtron si vijon:*

1. Altelecom në zbatim të Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, ka publikuar brenda afatit të përcaktuar tarifat e miratuara nga AKEP si më poshtë:
  - Pagesë për implementimin dhe aktivizimin e prefiksit për Z(P)B e shprehur në tarifë për të gjitha centralet (paguhet vetem një herë): 5.000.000 lekë;
  - Tarifë për implementimin e PB për çdo linjë telefonike (kjo tarifë paguhet vetëm një herë nga bartësi i thirrjeve për çdo pajtimtar): 500 lekë;
  
2. Në të njëjtën kohë Altelecom sh.a. drejtohet me këtë kërkesë ankimore brenda afatit të përcaktuar në nenin 140 të K.Pr.A, për ndryshimin e pjesshëm të VKD 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Altelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”, si edhe të kategorive / zërave të tjerë të pagesave dhe nivelit të tyre në referencë të amendimit të RIO-s së Altelecom në zbatim të VKD nr. 1692, datë 19.9.2011.
  
3. Argumentat ligjore, rregullatore dhe komerciale ku Altelecom mbështet ankimin administrativ:
  - 3.1 Altelecom ka vënë vazhdimisht AKEP-in në dijeni se implementimi i njëkohshëm detyrimeve rregullatore ka sjellë për Altelecom vështirësi teknike, rritjen e detyrueshme të investimeve në ifrastrukturë, sisteme, dhe software. Këto investime po bëhen krahas investimeve tashmë të planifikuara kryesisht në infrastrukturën e re të fibrës optike backbone, kalimit në rrjetin NGN, apo implementimit të sistemit të ri të billing-ut dhe të softswitch-eve.
  - 3.2 Të gjitha sa u tha më sipër, ndikojnë në mënyrë direkte në elementët e vlerësimit të kostonë së shërbimeve të Altelecom, dhe kanë impakt direkt në rritjen e kostonë së ofrimit të shërbimeve. Altelecom, i është nënshtruar procesit të vlerësimit të kostonë të shërbimeve të tij nga kompania PWC, për një periudhë më shumë se dy vjeçare, por ende nuk ka informacion për rezultatet. Tashmë, në kushtet e rrethanat e investimeve dhe implementimit të sistemeve të reja në rrjetin e Altelecom, është i nevojshëm rivlerësimi i kostonë në dritën e këtyre ndryshimeve.
  - 3.3 Altelecom, në përputhje me “Ligjin për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i është referuar praktikave dhe eksperiencave më të mira europiane në ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit dhe i është referuar po këtyre praktikave për kategoritë / zërat e pagesave dhe nivelin e tyre.
  - 3.4 Altelecom është mbështetur mbi një studim të Komisionit Europian “Studim mbi përcaktimin e kostonë për portabilitetin e numrit, zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit”. Edhe pse ky studim nuk përbën një akt detyrues apo rekomandues, përbën një dokument shumë të rëndësishëm dhe prestigjioz duke qenë se KE do të ishte i njëjti organ që do të ushtrojë pushtetin e tij nëse qëndrimi i komisionit për këtë studim do të duhej të kthehej në ushtrim vullneti për miratimin e një akti të ngjajshëm. Në këtë studim demonstron qartë se kostonë që shkaktohen në rastin e implementimit të zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit, kategorizohen të detajuara dhe argumentuara në detaje për çdo kosto të shkakuar në:
    - a) Kosto për implementimin;
    - b) Kosto konsumi.

- 3.5 AKEP, me VKD nr. 1778, datë 20.2.2012, ka reflektuar vetëm kostot për implementimin apo aktivizimin fillestar për mundësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve, ndërkohë që nuk janë marrë parasysh kostot e konsumit të cilat janë kosto të vazhdueshme dhe përfshijnë përveç të tjerave resurset për rrugëzimin dhe procesimin e thirrjes, për më tepër që në kushtet që Altelecom është në pozicionin e tranzituesit më të madh të thirrjeve me rreth 70 % operatorë të interkonektuar. Në kushtet e portabilitetit të numrit, ku implikohen një sërë procesesh dhe konfigurimesh të cilat rrisin kompleksitetin e veprimeve, kjo veçanërisht në rastin e para-zgjedhjes së bartësit.
- 3.6 Po ashtu, nuk janë marrë parasysh kostot administrative që shkaktohen për administrimin e çdo kërkesë nga ana e operatorit për aktivizim/anullim/ndryshim apo pezullim të shërbimit për çdo pajtimtar.
- 3.7 Gjithashtu, për pagesën për minutë, si një pagesë të cilën Altelecom e ka argumentuar me nevojën e rikuperimit të kostos që i shkaktohet rrjetit, në rrethanat e ofrimit të këtij shërbimi është e domosdoshme përfshirja e këtij elementi pagese. Altelecom, sjell si shembull rastin e British Telecom, i cili megjithëse njihet si një nga operatorët me rrjet nga më modernët dhe mirëstrukturuar, megjithëse i ndryshëm nga vendet e tjera, ka aplikuar këtë tarifë për minutë për rikuperimin e kostove të shkaktuara rrjetit si rrjedhojë e detyrimit për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit. Rrjeti i Altelecom, për momentin bazohet kryesisht në rrjetin TDM dhe po punohet për kalimin në rrjetin NGN, ky është një fakt i mjaftueshëm për të demonstruar vështirësitë dhe kostot që do t'i shkaktohen rrjetit, dhe rrjedhimisht nevojën për aplikimin e një tarife të tillë për një periudhë të përkohëshme deri në kalimin plotësisht në rrjetin NGN.
- 3.8 Altelecom-it do t'i duhet të menaxhojë të gjitha efektet dhe rrjedhojat që do të shkaktohen në vazhdimësi nga ofrimi i këtyre shërbimeve dhe është e drejta ligjore e çdo sipërmarrësi të marrë kompensimin për çdo kosto të shkaktuar shprehur kjo në një tarifë që të përmbajë edhe normën e arsyeshme të fitimit.
- 3.9 Bazuar në nenin 57/2/c, Altelecom me shkresë nr. 5444, datë 1.12.2011, ka sjellë raste të kategorive / zërave dhe nivelit të tarifave të ofrimit të shërbimeve të zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit edhe në vendet e rajonit. Nga studimi i RIO-ve të vendeve si Mali i Zi, Turqia apo Kroacia, vërehet se, në varësi edhe të topologjisë së rrjetit apo strategjisë komerciale të operatorit të çdo vendi, aplikohen të gjitha pagesat e propozuara nga Altelecom dhe në nivele të konsiderueshme madje. Vetë AKEP, ka mbajtur këtë qëndrim në VKD nr. 1778, datë 20.2.2012.
- 3.10 Sa i takon tarifës për implementimin apo aktivizimin fillestar të shërbimit, Altelecom, sqaron se vlera e përcaktuar nga AKEP, nuk përbën pëmbledhje të disa prej zërave të propozuar nga Altelecom, por qëndron në një linjë me tarifën e vendeve të rajonit për të njëjtën kategori pagese.
4. Sa më sipër Altelecom i kërkon AKEP-it, të miratojë për aplikim edhe zërat si më poshtë tarifave për shërbimet e zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit:

- 1- Pagesë mujore nga ana e operatorit duke filluar që nga data kur është bërë transaksioni i parë për të mbuluar koston e menaxhimit “live” në vazhdimësi të këtij produkti nga ana e operatorit të aksesit: 278,000 Lekë/muaj;
  - 2- Pagesa e operatorit për administrimin e kërkesave nga Albtelecom (aktivizimin/ndryshimin/anullimin/pezullimin) e Z(P)B për çdo pajtimtar, për të bërë konfigurimet përkatëse në sistemin e Albtelecom që të mundësojë për çdo pajtimtar për të cilin është kërkuar (aktivizimin/ndryshimin/anullimin/pezullimin) e Z(P)B: 100 Lekë/kërkesë;
  - 3- Pagesë për minutë (surcharge per minute) për rikuperimin nga kostoja e shkaktuar rrjetit për të mundësuar Z(P)B. Kjo pagesë do të vazhdojë për një periudhë prej 5 vjetësh (e ndryshueshme( deri sa të rikuperohen kostot e rrjetit: 0.5 Lekë/min;
5. Albtelecom, bazuar në në nenin 146, pika b, c, dhe nenin 138, pika 1, i kërkon AKEP-it:
1. Pezullimin e afatit të zbatimit të Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit” në mënyrë që të aplikohen zërat e pagesave të miratuara nga AKEP, njëherazi me zërat e pagesave për të cilat Albtelecom po ju drejtohet me këtë kërkesë ankimore.
  2. Ndryshimin e pjesëshëm të të Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit” duke i kërkuar AKEP-it, përfshirjen në të edhe të zërave të pagesave nga pika 1 deri në 3, të specifikuar më lart dhe pranimin e këtij ankimi.

II. AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimin administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., arsyeton si më poshtë:

1. AKEP sic ka cituar në pikat 6-8 të arsyetimit VKD nr. 1778, datë 20.02.2012, Albtelecom nuk ka dhënë informacion për të justifikuar që tarifën e propozuar prej tij për Z(P)B janë të orientuara drejt koston, por vetëm krahasim me tarifa të aplikuara në vende të tjera.
2. AKEP në përcaktimin e vlerave të tarifave të Albtelecom ka përdorur pikërisht për referencë nivelet e tarifave të aplikuara në vendet e tjera dhe sidomos të rajonit. Këto tarifa janë dhënë nga AKEP në Tabelat 1 dhe 2 (pikat 10 dhe 11) të arsyetimit të VKD nr. 1778, datë 20.02.2012;
3. Për sa i përket nivelit të tarifës së implementimit të Z(P)B, AKEP e ka përcaktuar këtë nivel rreth nivelit mesatar të vendeve të rajonit, duke marrë në konsideratë edhe tarifën mujore në vende që aplikohet një tarifë e tillë, si edhe tarifën e propozuar nga Albtelecom për pagesën mujore dhe për çdo kërkesë (zërat 2 dhe 3 të propozimit të Albtelecom të cituara në pikën 5 të arsyetimit të VKD nr. 1778 datë 20.02.2012, apo kërkesa e Albtelecom në pikat 1 dhe 2 të I/4 më sipër). Për sa i përket pagesës për minutë (zëri 6 i propozimit të Albtelecom i cituar në pikën 5 të arsyetimit të VKD nr. 1778 datë 20.02.2012, apo kërkesa e Albtelecom në pikën 3 e I/4 më sipër), AKEP ka dhënë arsyetimin për mospranimin e kësaj tarife në pikën 12 të arsyetimit VKD nr. 1778, datë 20.02.2012 dhe mban të njëjtin qëndrim arsyetues.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S:**

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a. me nr. 1406Prot., datë 20.3.2012, (nr. 531Prot. i AKEP, datë 21.3.2012) për *“Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1778, datë 20.2.2012, për “Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a. për ofrimin e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”*;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1778 datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues, *“Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”*;
3. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE